

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Shqyrtimi i kërkesës nr. 22, datë 06.05.2023, e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaç, Znj. I. Osmanaj, E. Mema.
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Përshëndetje, deklarojmë të çelur seancën e sotme, për shqyrtimin në themel të kërkesës 22, depozituar në datën 06.05.2023 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me objekt, kërkesë për vendosje sanksioni administrativ, gjobë në masën 3 mijë lekë, ndaj personave përgjegjës si më poshtë, zonja Ledina Agalliu, Sekretari i Përgjithshëm për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, zonja Zerina Bruçi, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës, zoti Ismail Shehu Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Joana Duro Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësis dhe Mbrojtjes Sociale dhe Risena Xhaja Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas shortit të hedhur relator i kësaj çështje jam unë Koli Bele, KAS është prezent si dhe administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, palë të tjera të pranishme nuk kemi. Seanca zhvillohet pa praninë e palëve, sipas nenit 135 devijues të Kodit Zgjedhor. Kërkesa paraprake nga anëtarët apo deklarime për konflikt interesesh nuk kemi. Vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Ftojme Sekretarin e Përgjithshëm të paraqes pretendimet e tij shkurtimisht, pak edhe rrethanat si dhe provat.

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale, në rrjetin social facebook në faqen zyrtare e 6 Ministrive dhe 10 Ministrave për të cilat pretendohet në denoncim, se postimet kanë përmbajtje politike në faqet zyrtare dhe përbëjnë pordorim të burimeve publike. Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet raportit të KRIIK-ut, të datës 24 prill 2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duke vlersuar se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, ka çelur hetimin administrativ, ku ka rezultuar se përgjatë të gjithë periudhës parazgjedhore, prej nisjes së periudhës katër mujore, të datës 13 janar 2023, ashtu edhe më parë, edhe deri më sot ditën që është bërë shqyrtimi, një pjesë të konsiderueshme të faqeve zyrtare të ministrive, janë përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste në formën e hashtagjev, tipikisht janë përdor slogane të bashkuar jo të ndarë “Shqipëria e Ardhmja Jonë” dhe “Ska Kohë për Pushim”. Pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, është provuar se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqen zyrtare të rrjeteve sociale facebook të institucioneve, subjekti i denoncimit janë përdorur hashtag dhe slogane me përmbajtje elektorale. Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara, është vlersuar se faqet e rrjetit social facebook, me emrin e ministrive janë faqe zyrtare të këtyre institucioneve. Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në facebook ,apo të çdo mjete tjetër elektronik, media sociale, institucione publike për publikimin e postimeve apo ripostimeve të cilat përmbajnë hashtag ose slogane me karakter politik elektorale në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve, përbëjnë përdorim të burimeve publike. Në këto kushte kur Ministria

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimave dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

e Turizmit, e Mjedisit, e Kulturës, e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, objekti i denoncimit ka bërë një sërë publikimesh të cilat përmbajnë hashtage, slogane me karaktere politike duke e keqpërdorur këto llogari institucionale, që përbëjnë burim publik, vlersohet nga Komisioneri se jemi përpara një shkelje administrative të Kodit Zgjedhor, pasi vërejmë qartazi promovimin e subjekteve zgjedhore për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Gjatë hetimit administrativ është vlersuar se postimet në llogari personale të ministrave nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe shkeljeve administrative. Në këto kushte referuar dhe vendimit numër 9, të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, personat përgjegjës për postimet janë sekretarët e përgjithshëm. Në këto kushtë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka propozuar KAS-it, marrjen e masave administrative për sekretarët e përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës, Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Z. K. Bele: Faleminderit, mesa kuptoj këtu bëhet fjalë vetëm për.. raportimi lidhet me periudhën 14-20 prill.

Z. Y. Merkaj: Ky është raporti i denoncuesit.

Z. K. Bele: Po monitorimi i KQZ-së është përtej kësaj periudhe apo vetëm për këtë javë?

Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit administrativ është shtrirë përtej kësaj periudhe.

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

Z. K. Bele: Kemi një qartësim deri se ku? Nëse e kemi.

Z. Y. Merkaç: Deri në datën 5 maj, që ka qënë dhe shqyrtimi administrativ është shtrirë dhe është parë dhe është hetuar për këto faqe.


Z. K. Bele: Tani, unë kisha një pyetje, në formë për të kuptuar më shumë. Këtu janë cituar këto këto tre slogane, që ju... të bashkua jo të ndarë “ Shqipëria e Ardhmja Jonë” dhe “S’ka kohë për pushim, ndërkohë që në postimet, të paktën slogani elektoral i përdorur nga Partia Socialiste është një... jo mbrapa përparë, diçka e tillë, vetëm përpara dhe nga një kontrollë që i kam bërë rutinë, disa faqeve kam parë, që është ky slogan i përdorur, në një kohë që këtu në material i referohet një slogan i vitit 2021, pa u shprehur se këtë do ta shikojmë më pas. A është konstatuar nga ju ky fakt?

Z. Y. Merkaç: Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se përdoret në të dy sloganet, edhe slogan i vitit 2023 edhe të dy sloganet, i vitit 2021 dhe 2022 të 6 mars-it. Duke qënë se përdorim këto slogane, atëherë është vlersuar se është promovuar një subjekt zgjedhor në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Z. K. Bele: Jam dakord! Po pse nuk është pasqyruar për vendim? Këtë desha të thosha.

Z. Y. Merkaç: Sepse siç e kam thënë dhe tek mbledhjet e kaluara, Komisioneri është fokusuar vetëm drejt denoncimit që ka bërë denoncuesi, edhe denoncuesi ka bërë vetëm këtu ku ka qënë fokusi i denoncuesit.

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimave dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

Z. K. Bele: Kuptoj, mirë po këtu një pyetje. Ju mendoni që ky slogan “të bashkuar, jo të ndarë” deri në vitin 2030, ngaqë është përdorur në Kongres nuk mund të përdoret? Ose, që ta kuptojmë, sot kemi një slogan që është i afishuar kudo “vetëm përpara” është i qartë që ky slogan lidhet me politikën e njërës forcë që indentifikohet kjo sot, ndoshta një slogan i përdorur dy vjet përpara i cili për më tepër ka shprehje, po e quaj të përgjithëshme, “të bashkuar, jo të ndarë” mund ta gjesh edhe në himn a diku tjetër. Si e shihni relacionin midis përdorimit të një slogani, të përdorur disa vite më parë dhe aktualizimit sot? Amendoni që është?

Z. Y. Merkaj: Duke qenë se ky slogan është përdor nga partia fituese, e cila ka fituar zgjedhjet edhe në zgjedhjet e kaluara, identifikon këtë subjekt zgjedhor, atëherë mendohet që është, bëhet promovim për këtë subjekt zgjedhor.

Z. L. Braho: Ju, mendoni se në psikikën e zgjedhësit ndikojnë akoma këto slogane, si ai i vitit 2021 dhe ai i vitit 2022? Pavarësisht se nuk janë slogane zyrtare, të Partisë Socialiste në këto zgjedhje, por që kanë qënë të së shkuarës, ju mendoni, ose më sakt Komisioneri është i ides këto vazhdojnë ndikojnë në psikikën e zgjedhësit dhe perceptojnë ministrите sikur po bëjnë fushatë për Partinë Socialiste.

Z. Y. Merkaj: Për sa kohë këto slogane, ripostojnë e ripostojnë vazhdimisht, mendojmë që ndikojnë.

Z. L. Braho: Po subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, ka qënë pjesë e procedurës së hetimit administrativ? Duke qënë se është forca e vetme qeverisëse,

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

në faqet e ministrive, ministrat janë të kësaj partie. A ke menduar se si subjekt përfitues, mund të jetë dhe Partia Socialiste?

Z. Y. Merhaj: Gjatë hetimit administrativ palët në proces kanë qënë vetëm ministrinë, nuk ka qënë Partia Socialiste as si subjekt zgjedhor.


Z. L. Braho: Edhe një pyetje tjetër, këtu shoh që pjesë e denoncimit duhet të kenë qënë edhe subjekte të tjera, ministri të tjera më konkretisht dhe shoh që është vendosur, moskonstatimi i shkeljes. Mund të na orientoni pak se nga ndryshojnë këto raste nga rastet për të cilat Komisioneri ka sjellë kërkesë për Sanksion?

Z. Y. Merhaj: Në denoncimin ishi 6 faqe të ministrive, edhe 10 faqet e ministrave, faqet personale të ministrave. E shpjegova pak më parë, që llogarite e tyre nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe shkeljes administrative. Kjo është konstatuar gjatë hetimit administrativ, nga Komisioneri.

Z. L. Braho: Përveç ministrave, shoh që shkronja A, është Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastukturës dhe Energjisë, pra që është njësoj si katër subjektet e tjera , që janë sjellë për sanksion administrativ. Për çfarë është kërkuar nga denoncuesi vendosja e sanksionit ndaj Sekretarit të Përgjithshëm dhe pse nga Komisioneri është pushuar?

Znj. I. Osmanaj: Sepse gjatë hetimit administrativ pra në momentin e shqyrtimit të këtyre provave rezultoi që të gjitha postimet të cilat ishin pretenduar nga denoncuesi që kishin përmbajtje elektorale politike, sikurse dhe përdorimi i sloganeve nuk

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

ekzistonin në faqen e ministrisë, në këto kushte për aq koh sa ne nuk e kishim të provuar këtë gjë, në momentin e shqyrtimit dhe administrimit të këtyre provave, pra nuk rezultoj e provuar kjo gjë për rrjedhojë u pushua dhe hetimi administrativ ndaj këtij institucioni.

Z. L. Braho: Pra denoncuesi vetëm sjell përmbajtjen nuk sjell foto ne këtë rast?

Znj. I. Osmanaj: Kishte sjell edhe foto por në momentin e parë që filloi hetimi administrativ, verifikuam faqen zyrtare të institucionit menjëherë pas administrimit të denoncimit, verifikuam bazueshmërinë e provës që solli denoncuesi, me ate faktike në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nuk na rezultoi që ishin këto postime.

Z. L. Braho: Mund ti kemi në dispozicion këto foto që ka sjell denoncuesi?

Znj. I. Osmanaj: Po, patjetër, e keni dhe bashkëlidhur ankesës.

Z. I. Rusmali: Në një çështje të mëparëshme, lidhur me keto postime, në mos gaboj me kërkesën e Komisionerit numër 21, në vendimin që ka paraprirë kërkesën Komisioneri shprehet, për kryetarin e bashkisë, kryetari i bashkisë është organ me karakter dhe natyrë politike dhe si i tille mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festimin e arritjeve politike apo të çdo lloj platforme tjetër politike për tërheqjen e elektoratit, siç ekuptoj unë vendimin ky ka qenë argumenti bazë që ka përjashtuar nga përgjegjësia administrative kryetarin e bashkisë. Tani pse ministrin nuk e shihni si organ me karakter dhe natyrë politike?

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023


Ku është dallimi midis ministrit dhe kryetarit të bashkisë? Jo, nuk kanë sjellë gjë për ministrin, por për ministrin thonë që ne nuk e provuam dot, tani ka koherencë qëndrimesh, o janë të dy politikë dhe përjashtohen se janë politik, ose nëse ministri nuk është politik ose pavarësisht se është politik duhet të hetohet, duhet të hetohen dhe kryetarët e bashkisë.

Znj. I. Osmanaj: Këto bëhen fjalë për postime që janë në faqet zyrtare, qoftë të kryetarëve të bashkive, qoftë në faqet personale të ministrave, ne nuk i kemi hyrë këtij hetimi, hetimi jonë administrativ ka konsistuar në postimet që janë bërë në faqe zyrtare të institucioneve, pra në faqet zyrtare të institucionit të bashkisë dhe në faqen zyrtare të institucionit të ministrisë.

Z. I. Rusmali: Mos të keqkuptohemi, unë e di që ju keni kërkuar marrjen e masave ndaj ministrave dhe unë nuk jam duke hapur temë për marrje masash, unë po kërkoj të kuptoj rracionalin e vendimeve të Komisionerit, jo të vendimeve të hetimeve të administratës së KQZ-së dhe pastaj të vendimeve të Komisionerit, nëse figurat politike të këtij vendi kanë të drejtë që në faqet e tyre personale të postojnë mesazhe me karakter politik dhe elektoral kjo është e vlefshme për të gjitha figurat politike. Nëse nuk kanë të drejtë nuk kanë të drejtë dhe duhet të hetohen të gjithë, po njëri ka të drejtë, tjetri nuk e dimë krijon kaos kjo. Denoncuesi ka kërkuar faqet personale të ministrave dhe për faqet personale të ministrave nuk mbahet i njëjti qëndrim, po thuhet i hetuam dhe nuk gjetëm prova.

Znj. I. Osmanaj: Jo, për çdo rast, bëhet fjalë vetëm për faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, kur kemi hyrë ke faqja gjatë hetimit administrativ, kur

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

kemi hyrë ke faqja për kërkimin e provës dhe administrimin e provës nga kjo faqe për ta ballafaquar edhe me provën e sjellë nga denoncuesi karezultuar që kjo provë nuk ishte postuar në këtë faqe, tani ose mund të jetë fshirë ose...

Z. K. Bele: Jo, nuk u kuptuam pyetja jonë ishte komenti, i njëjti argument që vlen për kryetarin e bashkisë si figurë politike vlen dhe për ministrin, nuk e shikojmë të evidentuar meqë denoncuesi e ka ngritur këtë. Ju, me të drejtë gjykoj unë jeni fokusuar te faqet e ministrive por se duke qënë se në praktikën e hetimit administrativ, ballafaqohet pretendimi i ngritur nga denoncuesi do të duhej që edhe ky pretendim, të hetohet duke thënë A, qëndrimi i njëjtë i mbajtur me kryetarin e bashkisë për atë arsytim që ju keni bërë ose B, nuk gjetëm prova në këtë rast ju keni vepruar me hetimin e faqeve zyrtare dhe këtu jemi në rregull, thjeshtë do të duhet që ky qëndrim të unifikohet nëse vlersohet nga administrata si logjik.

Z. I. Rusmali: Edhe një pyetje, tjetër nëse nuk gaboj, nëse gaboj më korrigjoni, lidhur me këto postimet në faqet e institucioneve përtej vendimeve të Komisionerit, ku ka urdhërime për fshirjen e postimeve kam përshtypjen ka patur dhe një njoftim publik nga ana e KQZ-së drejtuar institucioneve. Apo sështë e vërtetë?

Znj. I. Osmanaj: Ka patur një kërkesë kujtesë nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, por sikurse e kemi relatuar dhe në seancën e kaluar ka qënë edhe një organizim dhe një konferencë ku janë ftuar të gjitha institucionet për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në lidhje me detyrimet.

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023

Z. I. Rusmali: Ka patur një komunikim të Komisionerit. Ky komunikim është shtrirë deri tek subjekti elektoral Partia Socialiste?

Znj. I. Osmanaj: Ky njoftim ju është dërguar institucioneve.

Z. I. Rusmali: Subjektit elektoral jo?

Znj. I. Osmanaj: Jo.

Z. K. Bele: Besoj se skemi pyetje të tjera, përfundimisht, po zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Pranimin e kërkesës Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve vendosëm marrjen e masës administrative në vlerën 3 mijë lekë, për Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Drejtësisë sipas kërkesës.

Z. K. Bele: Mirë faleminderit KAS tërhiqet besoj për 15 minuta, do mundohemi të jemi rracional nga që sot kemi një numër çështjesh njëra pas tjetrës.

Rifillon seanca

Ora 11:49

Z. K. Bele: Mirë e çelim seancën, KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ në mbështetje të nenit 171 pika 2, vendosi: sanksionin administrativ në masën gjobë në vlerën 2500 lekë ndaj personave përgjegjës si më poshtë, zonjës Lediane Agalliu

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimave dhe Sanksioneve
Dt. 10.05.2023

Sekretare e Përgjithshme në ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, zonjës Zerina Bruçi
Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës, zotit Ismail Shehu Sekretari i
Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, zonjës Joana Duro Sekretare e Përgjithshme
ne Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjës Risena Xhaja Sekretare
e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kundër këtij vendimi bëhet
ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor,
me kaq seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 86

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

**10.05.2023
Ora 11:51**

RENDI I DITËS

2. Projektvendimi “Shqyrtimi i kërkesës nr.23, datë 06.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho, Z. K. Bele

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Rusmali: Atëhere fillojmë shqyrtimin në themel të kërkesës së Komisionerit nr. 23, për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Rakip Suli, kryetar i Bashkisë së Kamzës. Kolegët janë në dijeni të faktit që nga ana e administratës është bërë korigjimi i lapsusit teknik, lidhur me subjektin dhe vendimi numër 443 dhe kërkesa e Komisionerit i referohen shkeljeve të pretenduara të kryera nga kryetari i Bashkisë Kamëz. Është njoftuar subjekti, subjekti është njoftuar dhe është në mungesë, në këtë seancë shqyrtimi janë të gjithë anëtarë, është administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm, zoti Ylli Merkaj. Anëtarët nuk kanë ndonjë deklaram paraprakisht, nuk ka deklarime për konflikte të mundëshme interesi, kështuqë seanca mund të proçedojë rregullisht. Zoti Merkaj ju lutem na prezantoni elementët e kërkesës.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Po faleminderit, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar në datë 25 mars 2023, në adresën me email të koordinatorit për të drejtën e informimit, një denoncim ku pretendohet se janë ripostuar aktivitete të postuara në faqen zyrtare të zyrtarit dhe njëkohësisht kandidatit për kryetar bashkie në Kamëz, zoti Rakip Suli. Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi paraprakisht çështje ka vlerësuar se informacioni me të dhënat e dërguara krijonë bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, dhe ka nisur hetimin administrativ ndaj këtij denoncimi. Në përfundim të hetimit administrativ, gjatë hetimit administrativ kemi kërkuar bashkëpunim dhe i kemi dërguar kërkesë Bashkisë Kamëz, dhe personi përgjegjës për Bashkinë Kamëz nuk është, kemi administruar sërish përgjigjen e kërkesës të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Gjatë hetimit administrativ kemi konstatuar se personi i ngarkuar me detyra për të bërë raportimin dhe në rastin konkret ka qënë personi përgjegjës vet kryetari i bashkisë, kanë shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe në këto kushte Komisioneri i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative, në masën 3000 lekë, për kryetarin e Bashkisë Kamëz zotin Rakip Suli.

Z. I. Rusmali: Mirë faleminderit për këtë sqarim, ndonjë pyetje nga kolegët, s'ka asnjë pyetje. Mirë çështja është e qatrë, është dhe e përsëritur se dje kemi marr vendim për disa kryetar të tjerë bashkie. Përfundimisht ju i qëndroni kërkesës së Komisionerit.

Z. Y. Merkaj: Për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Kamëz, zotit Rakip Suli, në masën 3000 lekë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. I. Rusmali: Mirë e mbyllim këtë fazë të procesit, ne tërhiqemi për të marr vendim, vendimin do ta njoftojmë për 5 minuta.

Mirë riçelim seancën, KAS Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi u mbledh dhe shqyrtoi kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me shumicë votash vendosi, pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ, për denoncimin me numër 347 ID, vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Rakip Suli, kandidat për Kryetar Bashkie, Bashkia Kamëz, masën 100 mijë lekë, sipas nenit 172, pika 1, të ligjit numër 10 019 datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në pikën 1, të nenit 145, të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor. Vendimi shpallet sot në datë 10 maj 2023. Më kaq e deklaroj seancën të mbyllur.

Vendimi nr. 87

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

**10.05.2023
Ora 12:02**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 54 datë 08.05.2023, depozituar nga Partia Socialiste, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 455, date 06.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë-Lushnjë”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve’.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho, Z. K. Bele
Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
Të tjerë: KRIIK

Z. E. Lako: Çelim sot seancën publike të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, për verifikim dhe plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes për kërkesën ankimore numër 54, të datës 8.5.2023, paraqitur nga subjekti Partia Socialiste e Shqipërisë, me objekt kundërshtimin e vendimit numër 455, datë 6.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 386 nga KRIIK, për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në aksin rrugor kombëtar Tiranë-Lushnje. Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë Ervin Lako, sipas shortit të hedhur në datën 9 maj. Të pranishëm në seancë janë antarët e Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ka ndonjë përfaqësues nga subjekti ankues? Nuk ka. Palë të interesuara? Nuk ka. Vazhdojmë seancën edhe në mungesë të palës ankuese, zoti Sekretar i Përgjithshëm dy fjalë në lidhje me plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes për këtë ankim.

Z. Y. Merkaj: Po, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 54, me ankues Partia Socialiste e Shqipërisë, me objekt ankim kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me numër 455, datë 6.5.2023, i cili ka shqyrtuar administrativisht demoncimin numër 386 nga subjekti KRIIK, për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim me ligjin nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në aksin rrugor kombëtar Tiranë-Lushnje. Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore përcaktohet se i plotëson të tre elementët të parashikuar në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e kërkesave dhe vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, legjitimitimi ankuesit në bërjen e këtij ankimimi si dhe afatin kohor të parashikuar brenda 3 ditëve nga momenti i shpalljes. Për këtë arsye i kërkojmë KAS-it ta kalojë në seancë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj! Ka ndonjë pyetje nga anëtarët e KAS-it? Nuk ka. Atëhere mbështetur në nenin 126, të Kodit Zgjedhor, që përfshihen elementët e formës, nenin 130, të Kodit Zgjedhor, që ka të bëjë me kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e ankimit, pra legjitimitimin dhe afatin e ankimit, Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim dhe seancën e shqyrtimit në themel, nesër në datën 11 maj, në orën 13.30. Faleminderit!

Vendimi nr. 88

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

**10.05.2023
Ora 12:10**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 55, datë 08.05.2023, të depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho, Z. Koli Bele
Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
Të tjerë: KRIIK

Z. K. Bele: Mirë, çelim seancën publike të KAS, për të verifikuar plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore numër 55, të paraqitur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt kundërshtimin e vendimit të KQZ, nr. 452, datë 6.05.2023, për vlerësimin e raportit të monitoruesëve të fushatës zgjedhore, për periudhën e monitorimit 7 mars deri në 22 maj 2023. Pika 2 kundërshtimin e vendimit të KQZ nr. 456 datë 6.5.2023, për shqyrtimin administrativ demoncimi nr. 387 nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për heqjen e materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Ndryshimin pjesërisht i vendimit KQZ nr. 452, datë 6.05.2023, duke vendosur pushimin e hetimit administrativ në lidhje me këtë kërkesë për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në Bashkinë Tiranë, me vendndodhje rruga Artan Leja, rruga Milto Tutulani, rruga Margarita Tutulani, në Bashkinë e Elbasanit me vendodhje pranë universitetit Aleksandër Xhuvani. Pika 3/b pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën Nasip Pavllo, pranë Liceut Artistik, për arsyen specifike se kjo zyrë nuk i

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

takon subjektit zgjedhor PD, të regjistruar në këto zgjedhje nga KQZ, por i takon identitetit politik që identifikohet me Koalicionin “Bashkë Fitojmë” dhe për më tepër kjo nuk është zyrë elektorale në kuptim të Kodit Zgjedhor, por zyra e përherëshme politike, selia dega nr. 2 e PD, Tiranë. Pika c, pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike në Bashkitë Durrës, Tiranë, në lidhje me siglën e Kolaicionit “Bashkë Fitojmë”, në shtylla ndriçimi rruga Veli Dedi, Bashkia Tiranë. Pika 4, ndryshimin e vendimit KQZ numer 456, datë 6.5.2023, duke vendosur pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëherëshme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës Posta Shqipëtare, Kavajë, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Relator seance sipas shortit të hedhur datë 6 maj, jam unë, Koli Bele, verifikojmë prezencën e palëve, prezent është KAS si dhe administrata e KQZ-së, palë të tjera të pranishme a kemi?

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Franci Nuri, përfaqësues i Koalicionit Bashkë Fitojmë.

Z. K. Bele: Po, faleminderit! Kërkesa në këtë fazë ke? Përpara se të vazhdojmë me një paraqitje të shkurtër të rrethanave nga Sekretari i Përgjithshëm.

Z. Y. Merhaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 55 me ankues Partia e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, numër 452, datë 6.5.2023. kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 456, datë 6.5.2023 dhe ndryshim të pjesës së vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 452, duke vendosur pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesat e bëra në këtë vendim. Gjithashtu dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 456, datë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

6.5.2023 për të vendosur pushimin e hetimit administrativ. Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore konstatohet se i plotëson të tre elementët e parashikuar në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye i kërkojmë KAS-it të kalojë çështjen për shqyrtim. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: E kam dhe për administratën e KQZ-së edhe për përfaqësuesin e subjektit, në zyrën që ndodhet në rrugën Nasip Pavllo, pranë Liceut Artistik, a janë ekspozuar materiale elektorale të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”?

Z. Y. Merkaj: Nga një raport i monitoruesit të emëruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në datën 28.04.2023, ka raportuar se është hapur një zyrë zgjedhore e cila është në distancë jo më të vogël se 300 metra nga Qendra e Votimit që është te Liceu Artistik.

Z. I. Rusmali: A janë ekspozuar materiale zgjedhore të subjektit zgjedhor Bashkë Fitojmë në këtë zyrë?

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Nuk kam informacion, sinqerisht nuk kam informacion fare.

Z. I. Rusmali: Dakord, si mund t’ja bëjmë ne në mungesë të informacionit?

Z. Y. Merkaj: Po, kemi fotot, monitoruesi ka bërë fotot e zyrës elektorale dhe ka, gjithë fasada e zyrës është me xham dhe është vendosur logo të PD-së. Po, po, po ekemi.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. I. Rusmali: Jo, material zgjedhor të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, ka dy qëndrime të mundshme në këtë rast. Nëqoftëse ka ekspozim të materialeve zgjedhore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, panvarsisht se kush është administrator i zyrës, kujt institucioni i përket zyra e ku di unë me rradhe, domethënë KQZ-ja ka të drejtë ta konsiderojë zyrë elektorale. Nëqoftë se është zyrë elektorale e këtij koalicioni, ne duhet ta shqyrtojmë. Nëqoftë se nuk ka material elektorale të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, por është ashtu siç thotë kërkuesi, që është zyra politike e Partisë Demokratike të Sali Berishës, kjo është jashtë objektit të veprimit tonë. Është një parti politike që është e paregjistruar në zgjedhje, koalicioni nuk ka tagra përfaqësimi, dhe nuk ka të drejta legjitime të pretendojë asgjë në raport me zyrën e një subjekti tjetër, pra kjo na e ndan do ta shqyrtojmë apo jo, dhe për këtë duhet të na thoni ju, ka material të afishuar jashtë zyrës apo nuk ka. Përndryshe nëqoftëse nuk kemi informacion atëherë i bie që në këtë pjesë ta lëmë mënjandë dhe të merremi me pjesën tjetër.

Z. K. Bele: Më fal që të kuptoj se ndoshta unë sjam informuar te kjo pjesë sa duhet, ne kur flasim për materiale elektorale e lidhim vetëm me fushatën, pra me subjektet zgjedhore të regjistruara, mbase zyra që mund të ketë Partia e Pensionistëve apo një parti tjetër 100 metra apo 30 metra nga Qendra e Votimit nuk mbyllet për shkak se ka zgjedhje, apo jo? Pra në kuptueshmërinë time, më korigjoni nëse e kam gabim. Tani, mund të ketë një zyrë finance një parti, mund të ketë zyrën e kryetarit një parti që nuk është regjistruar në zgjedhje, dhe mund të jetë dhe përballë Qendrës së Votimit, çështja është kur ne referojmë për moshapjen e zyrave elektorale, lidhet me partitë pjesëmarrëse apo subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në këto zgjedhje apo jo? Dhe nëse e kuptova dhe ndërhyrjen Partia Demokratike në fjalë ose subjekti që pretendon që është Partia Demokratike, nuk është subjekt zgjedhor, nuk merr pjesë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

në zgjedhje. Nuk ka rëndësi, sipas konfirmimit thotë vajza, nga fotot tuaja nuk rezulton që të ketë logo të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, apo jo?

Z. L. Braho: Këta e kanë konsideruar sikur është zyrë e Partisë Demokratike të Shqipërisë, prandaj e kanë mbyllur, nuk e kanë konsideruar si

Z. I. Rusmali: Ledio këtë e kuptuam Ledio. Nëqoftëse akti i Komisionerit ka lapsus, lapsusin e rregullon Komisioneri, nuk vjen në procedurë ankimore. Nëqoftëse Komisioneri nuk do ta rregullojë lapsusin, subjekti i interesuar që është cënuar në të drejtën e tij të pronësisë, ankohet në Gjykatë për këtë punë, por nuk vjen në KAS. Ka rregulla për këtë, ne duhet të kuptojmë, zyra është në funksion të koalicionit apo jo. Nëqoftëse është në funksion të koalicionit vjen te ne, nëqoftëse nuk është nuk vjen te ne.

Z. Y. Merkaj: Atëhere monitoruesi i emëruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shkuar ka bërë monitorimin, atëhere monitorimi është bërë duke kaluar rruga e ka parë që gjithë fasada është vendosur logo e Partisë Demokratike, se kush është brenda te ajo nuk është parë. Dhe Komisioneri këtë ka bërë, i ka thënë Partisë Demokratike që ka vënë logon që ti këtë zyrë nuk mund ta mbash dot 300 metra, jo më afër se 300 metra nga QV-ja.

Z. I. Rusmali: Çojeni dhe një herë monitoruesin ta verifikoj më mirë këtë punë.

Z. Y. Merkaj: Vetëm të futët brenda dhe të pyesi i kujt partie je, se nga jashtë ajo duket e PD-së.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. I. Rusmali: Ka afishe jashtë.

Z. Y. Merkaj: Jashtë i ka sjellë fotot ai, monitoruesi, po.

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Unë nëse mund ta bëj një plotësim ndaj pyetjes a kishte apo jo materiale të afishuara këtë nuk e dija, por është e sigurt që zyra është në funksion të koalicionit, sikundër është dhe selia qendrore, kështu që për funksion të koalicionit ajo nuk ka pikë dyshimi.

Z. K. Bele: Nëse ka një zyrë që shërbej koalicionit por nuk identifikohet, se mund të ketë një zyrë finance, mund të ketë një zyrë që mbajnë boxet ata që këndojnë në miting, po është zyra e tyre e regjistruar për qëllime fiskale, por nuk identifikohet me materiale elektorale lejohet apo nuk lejohet?

Z. Y. Merkaj: Identifikohet ajo, nuk kemi si ta identifikojmë nëqoftëse nuk ka materiale nuk e identifikojmë, nuk e dimë që është zyrë partie, ajo identifikohet në momentin që vendoset logo e partisë dhe sloganet. Në këtë rast është vendosur logo e PD-së.

Z. K. Bele: Po kemi situatën që nuk ka hyrë partia por Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Z. Y. Merkaj: Atëhere është ajo që thotë zoti Rusmajli që Partia Demokratike duhet ta denoncojë për përdorimim e logos së saj.

Z. K. Bele: Pra është çështje, e kuptova, kjo është situatë si

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. E. Çefa: Tani Komisioneri a ka dhënë urdhër që të mbyllet zyra për efekt të zgjedhjeve datë 14, apo ka dhënë urdhër që të zhvendoset prej aty selia e degës fare, të marrin zyrë tjetër në lagje tjetër.

Z. Y. Merkaç: Po pra të zhvendoset 300 metra larg Qendrës së Votimit.

Z. E. Çefa: Vetëm për zgjedhjet?

Z. Y. Merkaç: Po vetëm për zgjedhjet.

Z. E. Çefa: Ose në alternativën mos të funksionojë deri për zgjedhje, se qëllimi është të ndalojmë propagandën elektorale 300 metra larg Qendrave të Votimit apo jo? Tani ai ka lidhur një kontratë që ndoshta e ka për 5 vjet, ai tani smund të prishi kontratën e qerasë dhe të shkojë të kërkojë me qera një objekt tjerër sepsë mbas tre ditëve janë zgjedhjet. Kështuqë nëqoftë se heq këtë, pra dua të them që, ka qënë dhe ajo alternativa të urdhëroj heqjen e të gjitha logove dhe posterave elektorale, që identifikojnë apo që ndikojnë në subkoshiencën e zgjedhësve të asaj zone aty, në mënyrë që efekti juridik të jetë i limituar, pra mos detyrohet partia apo ai që e përdor, të shkojë të kërkojë të prishi në gjyq kontratën e qerasë dhe të shkojë të kërkojë objekt tjetër. Domethënë këtë doja më tepër si sqarim.

Z. I. Rusmali: Nëqoftëse janë distancë të afërt me Qendrën e Votimit, nuk është vetëm problemi i afishimeve, i ekspozimit mesazhit viziv, është dhe problemi i grumbullimit të njerëzve ditën e zgjedhjeve, ka rregulla që nuk lejojnë grumbullimin e njerëzve nga partitë politike në ditën e zgjedhjeve. Kjo mund të jetë një argument në favor të mbylljes. Unë nuk e di se çfarë argumenti ka përdorur Komisioneri, por

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

nëqoftëse i referohemi ligjit, është ky shqetësim ditën e zgjedhjeve, jo ditët e tjera, jo ditët e fushatës.

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Akti i konstatimit të Policisë Bashkiake, prandaj i solla. Është kjo e rrugës Pavllo dhe kjo e Margarita Tutulanit, prandaj nuk është se po ankohemi në ajër.

Z. I. Rusmali: Më fal të bëj një pyetje, ndonjë kontratë qeraje për atë zyrë keni ju si koalicion? Keni një titull juridik mbi të?

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Pyetje e drejtë, në dispozicionin tim nuk e kam dijeninë për këtë gjë.

Z. I. Rusmali: Na e sjell? Interesohesh të na japësh përgjigje për atë?

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Mund të intersohem patjetër.

Z. I. Rusmali: Interesohu.

Z. E. Çefa: Një pyetje tjetër kam unë për përfaqësuesin e ankimuesit. A është egzekutuar, dakord është procesverbali, por defacto a i është venë kyçi zyrove, janë mbyllur, janë nxjerrë jashtë njerëzit nga aty?

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Përderisa është vendosur akti i konstatimit të policisë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. E. Çefa: Pa u konsideruar i formës së prerë vendimi i Komisionerit, megjithë ankimin, se jeni në procedurë ankimi nuk është vendim i formës së prerë apo jo? Do pritet dhe Kolegji Zgjedhor si rregull.

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Ne pikërisht prandaj e bëmë ankimin, në mënyrë që jo vetëm për këtë qendër ketu po edhe pikat e tjera që keni ngritur mos të zbatohen derisa të marri formë vendimi.

Z. E. Çefa: Edhe një tjetër Policia Bashkiake e ka mbyllur dhe logot kanë ngelur aty prapë? Megjithëse zyra është e mbyllur apo jo?

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Në dijeninë time logot kanë ngelur se janë të afishuara.

Z. E. Çefa: Pra prapë ndikohet qytetari në

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Këtë nuk e di a ndikohet apo jo.

Z. E. Çefa: Duhet nxjerrë një urdhër që

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): A ndikohet apo jo është çështje subkoshience, këtë pjesë nuk është se e kam ndjekur në terren, nuk e di unë personalisht.

Z. K. Bele: Kjo situatë ka diskutim, ne po thellohemi pak, kështuqë po kërkojmë një 5 minutësh për ta diskutuar lidhur me kalimin dhe në seancë.

Dakord, riçelim seancën e cila është shtyrë për të sqaruar lidhur me një qëndrim të përfaqësuesit të ankuesit, lidhur me pikën 3/b, të ankimit nr.55 ku bëhet fjalë vetëm

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

për raporte që ankuesi ka në lidhje me këtë pikë të kërkesës ku është një paqartësi që ka të bëjë me legjetimimin. Po zoti Nuri.

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): Po i nderuar zoti Bele, ne gjatë kësaj kohe arritëm të marrim kopjen e kontratës së qerasë për ambientet përkatëse dhe nga kontrata që do t'ja vëmë menjëherë në dispozicion KQZ-së rezulton te nei 4, se qiramarrësi do ta përdorë ambientin për zyra të degës së Partisë Demokratike PD, me shkronja nistore, kontrata është përpiluar në prill të 2022, me afat 1 vjeçar me të drejtë rinovimi nëse palët bien dakord, kemi dhe dy fotografi që sapo janë bërë që mi dërguan para pak minutash, që tregojnë qartë që nuk ka simbole elektorale, po themi, dhe nuk ka rrezik që të konfonduar zgjedhësit, nuk janë përdorur për të konfonduar zgjedhësit, këto janë zyrat qendrore të njësisë nr.2 po themi, të degës nr.2 të Partisë Demokratike, përfaqësuar nga zoti Berisha, dhe që është në funksion të Kollacionit “Bashkë Fitojmë”, sikundër është dhe selia te Bulevardi Zhan Dark etj. Pra kanë njëjtin status le të themi.

Z. K. Bele: Pra, që ta kuptojmë drejt. Kjo zyrë ju shpjeguat pjesën kush është qeramarrësi, kërkimi juaj këtu lidhet me një zyrë të Partisë Demokratike të cilës gabimisht sipas jush i është penguar të funksionoj, apo lidhet me një kërkim të Kollacionit “Bashkë Fitojmë”. Pra duhet të ndani këtë moment sepse kemi një diskutim procedural lidhur me këtë kërkim, pasi siç u parashtrua dhe nga anëtari Rusmali, kërkimet për subjektin Partinë Demokratike nuk është kjo trupë para së cilës ju mund ta kërkoni.

Përfaqësuesi i BF(F.Nuri): E kuptoj rrezikun e moslegjitimitit për këtë pjesë, por duke qënë se realiteti është ky, që kjo zyrë pavarësisht logos dhe çfarë ka pasur të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*


afishuar është një zyrë që ne si koalicion e pretendojmë, pra ajo është në shërbim të koalicionit tonë dhe nuk mundet, prandaj kemi ardhur kemi investuar KAS-in jo pa qëllim. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet inspektorëve në gjykimin tonë, të gabuar patjetër se nuk kishte pse ta përfshinte fare të zyrat zgjedhore, pra nuk janë zyra zgjedhore në kuptimin që janë hapur rishtazi për qëllime zgjedhore, është një zyrë që ka mbi 2 vite aty, është zyrë permanente pikërisht, dhe dëmi jonë që mund të na bëjë për analogji në rast se do bëhej një gabim tjetër, po mund të kishte ndodhur mbyllja e ndonjë dege tjetër, pse jo dhe e selisë qendrore, pastaj ne as nuk legjitimohemi dot për arsye që dihen, figuron PD dhe kështu që mbyllet qarku dhe ne skemi çfarë bëjmë. T'ja vë në dispozicion KQZ-së, administrata ju lutem.

Z. K. Bele: Atëhere KAS i konsultuar vendosi:

Kalimin e kërkesës ankimore nr 55 në tërësi dhe dhe për pikën 3/b, gjithashtu kalimin e kësaj kërkesë me shumicë për efekt të legjitimit. Seanca e kësaj caktohet ditën e nesërme ora 13:30. Në fakt ne do të tentojmë orën 14:00 pasi kemi një kërkesë tjetër në 13:30 dhe dita e nesërme data 12 ora 14:00. Seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 89

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

**10.05.2023
Ora 12.35**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Zbatimi i vendimit të Kolegjit Zgjedhor lidhur me kërkesën ankimore nr. 53, datë 27.04.2023, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë””.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** BF, PL, PDIU
- **Të tjerë** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Riçelim edhe një herë seancën në mënyrë të përsëritur për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 53 me subjekt ankues Partinë e Lirisë, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 404, datë 24 prill 2023 për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, ndryshimin e këtij vendimi duke caktuar Partinë e Lirisë si partinë politike të cilës i lind e drejta e propozimit të anëtarit të katërt të GNV-ve për zgjedhjet e datës 14 maj. Sikurse e dini, KAS sot po e ripërsërit këtë seancë në zbatim të vendimit nr.17 të datës 9 maj 2023 të Kolegjit Zgjedhor, i

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

duke konstatuar absolutisht të pavlefshëm vendimin nr. 71, datë 2 maj 2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, si dhe duke urdhëruar KAS-in që të marrë këtë vendim, pra të shqyrtojë edhe një herë në seancë publike dhe të marrë vendimin për këtë çështje brenda datës 10. Ne, në zbatim të këtij vendimi, sot në datën 10 maj po riçelim seancën. Verifikojmë prezencën. Është e plotë trupa e KAS-it, relatori i çështjes tashmë e dini, por për procesverbal po e përsëris, jam unë anëtari Elvis Çefa. Është prezent përfaqësuesi i Partisë së Lirisë në cilësinë e ankimuesit; janë prezentë persona e interesuar, përfaqësuesit e PDIU-së; është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, që në këtë procedim do të përfaqësojë edhe Komisionerin Shtetëror bashkë me stafin e tij. Duke qenë se nuk kemi pengesa të tjera dhe i kemi edhe deklaratat për pajtueshmërinë nëse konflikti e interesit i kemi ezauruar në seancën paraprake të kësaj çështjeje, ndaj po ia jap menjëherë fjalën përfaqësuesit të ankimuesit të Partisë së Lirisë për të na e relatuar edhe një herë çështjen. Ne sigurisht e dimë, edhe zoti Bele është njohur në detaje me këtë, ndaj do t'ju lutem të jeni sa më konciz në parashtrimet tuaja. Kjo vlen për të gjitha palët. Faleminderit!

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti relator! Ashtu siç thatë edhe ju në fjalën tuaj, jemi përpara një vendimi, ndonëse ne në fakt na ka ardhur vetë në formën e dispozitivit dhe duke qenë se nuk kemi brendinë e tij për të dalë në konkluzione se përse një organ epror duke arsyetuar ligjërisht, pavarësisht dispozitivit që është i qartë, jua ka kthyer juve vendimin tuaj nr. 71 duke pranuar pjesërisht kërkesë-padinë ashtu siç e cituat edhe ju. Kjo është gjëja e parë dhe do t'i luteshim KQZ-së në qoftë se është në dijeni të vendimit dhe ka një kopje të tij, të na i vërë në dispozicion, të na lihet pak kohë për t'u njohur me të, në mënyrë që arsyetimi i gjykatës të jetë pjesë e mbrojtjes sonë. Po ashtu, kisha edhe një kërkesë të karakterit procedural, se ju thatë që janë ezauruar në fazën e parë disa kërkesa të karakterit procedural, por tashmë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

jemi në një fazë ekspost, jemi në një fazë që ju si trupë kolegjiale keni marrë një vendim, jemi në fazën kur ne këtë vendimmarrje e kemi kundërshtuar në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor; jemi në fazën kur ne vendimmarrjen tuaj e kemi analizuar në detajet e veta dhe nga ajo që është brendësia e vendimit tuaj që mban numrin 71, datë 2.5.2023, për sa i përket asaj që është vendimmarrja e dy anëtarëve të KAS-it dhe kryesisht të zotit Rusmali, mund të themi që jemi në kushtet e një papajtueshmërie të detyrës ose të një kërkesë tonën procedurale për sa i përket pjesës së përjashtimit të tij për shkak të qëndrimeve të mbajtura për këtë vendim, që janë kryekëput qëndrime politike, qëndrime të një subjekti politik që zoti Rusmali po tenton t'i bëjë shërbime për të arritur një pozicion të caktuar politik, që i duhen votat e ligjvënësve shqiptarë, i duhen votat edhe të PDIU-së, kështu që kërkojmë nga ana juaj që me vendimmarrje të ndërmjetme të mblidheni dhe të vendosni për kërkesën tonë të bërë verbalisht në këtë rast lidhur me përjashtimin e zotit Rusmali në këtë gjykim për shkak të konfliktit të hapur të shprehur në vendimmarrjen nr. 71, datë 2.5.2023. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit, zoti Kaziaj! Dakord, po e konsiderojmë sigurisht në këtë fazë të procesit kërkesën tuaj paraprake për përjashtimin e një anëtari. Ne proceduralisht do të na duhet ta ndërpresim pak këtu seancën për të marrë vendimin për shqyrtimin e kërkesës suaj.

Z. Sh. Sulo: Mundem?

Z. E. Çefa: Patjetër. Kërkesë paraprake keni edhe ju, apo prapësime?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. Sh. Sulo: Prapësime. Në lidhje me kërkesën që u bë nga përfaqësuesi i LSI-së nuk duhet të merret parasysh nga ana juaj. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor ishte shumë i qartë. Arsyeja pse u mor ai vendim nga Kolegji Zgjedhor ishte nul vendimi i KAS-it për shkak të mosvotimit të një anëtari. Në bazë të nenit 158, shkronja “c”, i kërkoj KAS-it që të mblidhet brenda një afati të caktuar konform ligjit dhe në kërkesëpadinë e paditësit, në rastin tonë ankuesit, ka qenë thjesht vetëm kundërshtimi i vendimit në seancë ku u bë një shtesë mbi objektin e kësaj padie. Në lidhje me çfarë u tha për një nga anëtarët e KAS-it, unë nuk e kam tagrin, nuk e kuptoj si mund të gjykohet apo të ngjyroset e të tjera e tjera, sepse në atë Kolegji Zgjedhor u dëgjuan jo për një, por për dy persona, patronazhista e shumë elemente të Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë apo edhe Komisionerit. U thanë shumë ngjyrimë. Ne jemi përpara një trupe gjyqësore kuazi dhe kërkojmë marrjen e këtij vendimi për faktin se edhe data e zhvillimit të zgjedhjeve është shumë e afërt. Është vetë ankuesi, paditësi, që i është drejtuar kësaj trupe e i thotë herë pas here “ju lutem , mos harxhoni kohën kot”. Ju lutem, të merrni vendim konform ligjit. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit!

Z. A. Kaziaj: Mund të bëj një replikë para se ta marr fjalën zoti Rusmali në lidhje me atë çfarë tha përfaqësuesi i maxhorancës, se përfaqësuesi i maxhorancës është në këtë rast, duke mbrojtur qëndrimet e opozitës të unifikuara të opozitës së bashkuar, përfaqësuesi i maxhorancës haptazi tregon se cilës dhe cilit krah politik i përket. Këto janë veprime që tregojnë se kujt i përket realisht kjo parti.

Z. E. Çefa: Të lutem, t'i përmbledhim detajet teknike për të cilat jemi mbledhur. Zoti Rusmali.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. I. Rusmali: Zoti Kaziaj, ju ngritët pretendimin se vendimi ynë i mëparshëm në arsyetimin e dy anëtarëve të KAS-it, të zotit Lako dhe timin, ka qëndrime që janë thellësisht politike dhe jo juridike, jo të argumentuara ligjërisht. Unë kam dy pyetje: e para, pretendimi duhet provuar dhe ju nuk bëtë analizë provash në kërkesën tuaj. Minimalisht mund të na thoni paragrafin konkret të opinionit të shprehur nga dy anëtarët që juve ju duken politike dhe jo argumente juridike? Pyetja e dytë, mendimi i shprehur aty është i dy anëtarëve. Pse njëri anëtar është në kushtet e papajtueshmërisë dhe tjetri nuk është? Ka ndonjë shpjegim për këtë?

Z. A. Kaziaj: I nderuar zoti Rusmali, patjetër. Faleminderit për pyetjen! Pavarësisht që qëndrimi ka qenë, siç e thatë edhe ju, i dy anëtarëve, ne tashmë i njohim shumë mirë në arsyetim se cili është anëtari që ka shprehur qëndrime dhe anashkalime të ligjit duke pasur orientime të pastra politike, që në këtë rast anëtari jeni ju. E dimë fare mirë që ju e quani ligjin të ngurtë, ndërkohë keni qenë ju ligjbërësi, ndërkohë që jeni ju personi që po i bëni privilegje një partie të caktuar dhe ligjvënësve të kësaj republike, të paktën asaj të maxhorancës, për të arritur qëllimet tuaja personale të karrierës suaj, që fare mirë e dini për çfarë pozicioni unë po flas.

Z. E. Çefa: Zoti Kaziaj, të lutem.

Z. A. Kaziaj: Po i përgjigjem pyetjes, zoti relator. Më lini të mbaroj, ju lutem. Kur merret fjala, unë nuk ju ndërpres.

Z. E. Çefa: Dakord, opinionet personale mund...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. A. Kaziaj: Nuk janë opinione personale. Është një fakt i njohur botërisht. Qëndrimet e mbajtura kanë qenë kryekëput në kundërshtim me ligjin. Arsyetimi i bërë për ngurtësinë e ligjit nga zoti Rusmali dhe interpretimin ekspolitik që bën...

Z. E. Çefa: Argumentimin mbaje në këtë nivel.

Z. A. Kaziaj: Po, në këtë nivel po e mbaj, por po përgjigjem, se më bëri dy pyetje. Ju lutem, zoti Çefa, keni mirësinë të më dëgjoni.

Z. E. Çefa: Sigurisht, do t'ju dëgjoj deri kur ju të thoni nuk kam më çfarë të them, por përmbajuni pak etikës dhe qëndroni në arsyetimet teknike, ligjore, juridike.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, ju zoti Çefa! Po e vazhdoj aty ku e lashë. Fakti është që qëndrimet e mbajtura nëpërmjet vendimit nr. 71, jo më kot i bëri edhe pyetjet, sepse e di shumë mirë që çfarë qëndrimesh ka mbajtur zoti Rusmali, janë qëndrime kryekëput për arritjen e një qëllimi të caktuar, duke i bërë shërbim politik partisë në pushtet dhe duke kërkuar votat në Kuvend për pozicionin që ka ndërmend të arrijë.

Z. I. Rusmali: Cilat konkretisht?

Z. A. Kaziaj: Cilat? Arsyetimi. Ju flisni për ngurtësi të ligjit elektoral lidhur me nenin 183/8.

Z. I. Rusmali: Çfar them unë për ngurtësi të ligjit? Citoje dhe thuaj pse është politik.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. A. Kaziaj: Zoti Rusmali, më lini kohën se do t'jua citoj. Ngurtësia e ligjit nuk ka të bëjë me interpretimin që keni bërë ju. Ngurtësia e ligjit ka të bëjë me një dispozitë të qartë kalimtare që ligjvënësi, ju ligjshkruesit e keni bërë për të arritur...Ndonëse e keni bërë në vitin 2020, ndërkohë që qëllimi i vitit 2017 ishte i qartë se si ishte ndarë shumicë-pakicë në vetvete Kuvendi i Shqipërisë në konstituimin e tij. Për sa i përket pjesës se cilat nga argumentet tuaja kanë të bëjnë me qëndrime politike ose të njëanshmërisë së hapur të mbajtur nga ana juaj, unë po jua kthej me një pyetje tjetër: po sikur të mos regjistrohej PDIU-ja, do të ishte prapë i ngurtë ligji dhe cili do të ishte subjekti që do t'i përkiste numëruesi i katërt?

Z. I. Rusmali: Ju bëni kërkesë dhe ju japin përgjigje.

Z. A. Kaziaj: Kërkesën e keni publike, me zë e figurë. Ndërkohë, më jepni përgjigje lidhur me papajtueshmërinë tuaj...

Z. I. Rusmali: Në qoftë se ju kërkoni përjashtimin tim dhe pastaj të bëni kërkesën, do të thotë që ju nuk e doni përgjigjen të paktën nga unë për kërkesën që bëni, sepse kërkoni përjashtimin tim, ndërkohë që keni një gjë të paqartë, doni që t'ju sqarohet diçka. Meqenëse e bëtë këtë pyetje, unë nuk kam marrë ende përgjigje për pyetjet e mia, por unë po ju jap përgjigje për këtë që doni. Po ju jap përgjigje duke i kthyer pak në kohë gjërat. Zoti Sulo, përfaqësues i PDIU-së ka qenë në Komisionin e Reformës Zgjedhore ekspert, sikurse kam qenë edhe unë, por ai në një pozicion tjetër, unë bashkë me një koleg tjetër nga pozicioni i draftuesit, ekspert i pavarur i kërkuar nga PD-ja dhe nga PS-ja dhe i kontraktuar nga ndërkombëtarët. Ky ka qenë pozicioni im atëherë. Kur janë bërë marrëveshjet për Kodin Zgjedhor me përfaqësuesin e LSI-së, të PD-së, të PS-së, të PDIU-së, ndoshta edhe të PR-së, nuk

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

e mbaj mend mirë, është vendosur që për zgjedhjet e vitit 2021 dhe zgjedhjet e vitit 2023 grupet e numërimit do të përbëheshin nga PD-ja, PS-ja, LSI-ja dhe PDIU-ja. Kjo është marrëveshje e palëve në negociatë për miratimin e Kodit. Ndryshe, PDIU-ja që kishte zë, nuk kishte anëtarësi në komision, nuk e jepte pëlqimin e vet. Ka ndodhur kjo gjë, marrëveshja politike e inkorporuar në një tekst ligjor është interpretimi i vetëm që i bëhet tekstit ligjor, sepse është interpretimi historik i tij. Pra, në qoftë se ju vini sot e thoni duhet të kemi fleksibilitet se kohët ndryshojnë dhe ndryshojnë rrethanat, ndryshojnë vendimet, unë nuk e them dot këtë, sepse pika 8 e nenit 183 është bërë posaçërisht për këtë gjë. Kohët ndryshojnë, ndryshojnë rrethanat, por ky vendim nuk do të ndryshojë. Marrëveshje politike e LSI-së, PD-së, PS-së, PDIU-së e ndonjë tjetri. Kjo ka qenë. Çfarë ka ndodhur? Unë jam i vetëdijshëm për normat juridike dhe interpretimin e normave juridike. Ato nuk të lënë të gabosh. Kushdo që të jetë personi që e bën këtë punë, në qoftë se ndjek rregullat e zbatimit të normave juridike del gjithmonë në një konkluzion; në qoftë se devijon nga rregullat, pastaj del në konkluzione të ndryshme. Duke mbajtur në konsideratë kontekstin historik, në qershor të vitit 2020 palët me mirëkuptim vendosën që grupet e numërimit të përbëhen nga PS, PD, LSI, PDIU. Ngarkuan draftuesit që të shkruajnë dispozitën vetëm në këtë mënyrë që rezultati në vitin 2021 të dilte PS, PD, LSI dhe PDIU dhe në vitin 2023 të dilte PS, PD, LSI dhe PDIU. Çfarë ndodhi? Ndodhi që në vitin 2021 LSI-ja përdori një akses të tërthortë në sistem, vuri në lëvizje mekanizmat dhe i hoqi subjektit me të cilin kishte bërë marrëveshje në vitin 2020 të drejtën për të propozuar anëtarin e grupit të numërimit...

Z. A. Kaziaj: Nuk jeni i saktë. Nuk ia hoqi LSI-ja. Edhe Kolegji vendosi pro LSI-së, ia hoqi ligji, jo LSI-ja.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. I. Rusmali: Edhe Kolegji vendosi pro LSI-së, por si LSI-ja, si KAS-i, si Kolegji nuk bën një gjë, nuk atakuan marrëveshjen. Thanë marrëveshja qëndron, i takon PDIU-së, por meqenëse është në koalicion, nuk po ia japim këtë herë. Sot Partia e Lirisë, trashëgimtarja e LSI-së, e cila i merr me vete edhe trashëgiminë LSI-së, se ia merr, të gjitha marrëveshjet e LSI-së janë të Partisë së Lirisë sot kushdo qoftë kryetari, kushdo qoftë nënkryetari. Se kjo është legasi, kjo është trashëgimia politike. Nuk mohohen se ndryshoi kryetari. Pra, sot, Partia e Lirisë vë në lëvizje sistemin me kërkesë për të prishur marrëveshjen e vitit 2020. T'i hiqet kësaj partie, se nuk është ky ligji. Tani, unë jam politik, ju jeni ligjor? Po ju keni ardhur këtu me kërkesë për të prishur marrëveshjen që ka qenë në themel të hartimit të Kodit Zgjedhor të vitit 2020, kur Kodi Zgjedhor i vitit 2020 është miratuar deri sot dhe është në fuqi. Si qenkam unë politik, kur politik jeni ju që lëvizni nga ligji?

Z. A. Kaziaj: Zoti Rusmali, unë jam përfaqësues teknik. Sa i përket pjesës së të qenit politik në këtu, si përfaqësues teknikë, do të shohim dhe pjesën e papajtueshmërisë tuaj me politikën. Keni marrë përsipër...

Z. Sh. Sulo: Zoti Çefa, a mund të bëj një ndërhyrje për procedurë, ju lutem? Nëse kjo deri tani ka ardhur për t'u bërë midis përfaqësuesit të LSI-së dhe një anëtar...
(Diskutime pa mikrofon)

Z. A. Kaziaj: Tani, zoti Rusmali, ju, vetë nga qëndrimi juaj...

Z. E. Çefa: Dakord, do të flisni të gjithë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. Sh. Sulo: Ja, po i përgjigjem se e kishte me mua.

Z. A. Kaziaj: Po, pra unë po i përgjigjem teknikisht.

Z. I. Rusmali: Duhet Peçua që të më përgjigjet, sepse ti nuk përgjigjesh dot.

Z. A. Kaziaj: Zoti Vasili, Peçua nuk është shoku juaj. Lërimi tani etiketimet, sepse edhe këtu po tregoheni politik. Duhet të mbani lartësinë e pozicionit që keni, pikë së pari, pa etiketime të ndonjë personi që ka detyra të larta në parti të time, ju lutem, të qëndroni...

Z. I. Rusmali: Moralistin mund ta bëjnë vetëm njerëzit që janë të kulluar.

Z. A. Kaziaj: Po, pra, ata që shkruajnë tekstin e një ligji dhe pastaj bëhen pjesë e një trupe gjyqësore, quazi gjyqësore për të bërë *legge ad personam*, siç keni bërë juve.

Z. I. Rusmali: Nuk bën politikanin, nuk bën...

Z. A. Kaziaj: Zotëri, ju keni bërë *legge ad personam*. Ju keni ardhur në një pozicion që e keni quajtur vetë ligjin dhe e keni bërë katapultomë siç keni dashur vetë. Qëndrimet tuaja politike me vendim...

Z. I. Rusmali: Dispozitat tranzitore të një ligji janë gjithmonë *ad personam*.

Z. A. Kaziaj: Jo, jo.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. I. Rusmali: Dispozitat tranzitore të një ligji, janë gjithmonë *ad personam*.

Z. A. Kaziaj: Gjithmonë, meqë jeni marrë ju si ekspert i jashtëm keni bërë *legge ad personam*. Të 188 nene të Kodit Zgjedhor i keni bërë siç keni dashur vetë për të arritur ato që keni pasur ndërmend të arrini ju.

Z. E. Çefa: Zoti Kaziaj, dolëm nga debati për të cilin jemi këtu, prandaj ju lutem shumë, unë i mora mendimet e të gjithëve,

Z. A. Kaziaj: Zoti Çefa, flasim për një dispozitë ligjore. Unë nuk bie në nivele të etiketoj njerëz.

(Diskutime pa mikrofon)

Si e mbroj unë interesin dhe si po e Mbroni ju interesin e atyre që po iu shërbeni, po e tregoni fare qartë me zë dhe figurë. Unë mbroj interesin enjë partie politike për të cilën unë jam zgjedhur përfaqësues ligjor. Ju jeni funksionar publik, i cili duhet të mbajë paanshmëri dhe këtë gjë. Dhe këtë komunikim të sapo bërë nga zoti Rusmali duhet ta mbani parasysht në momentin që do të mblidheni dhe do të vendosni lidhur më papajtueshmërinë e tij dhe qëndrimet e mbajtura për përjashtimin e tij.

Z. E. Çefa: Mirë, atëherë..

Z. I. Rusmali: Kërkesa për papajtueshmëri në çfarë reference ligjore mbështetet dhe cili është shkaku ligjor?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. A. Kaziaj: Ju lutem, nuk jeni ju që merrni në shqyrtim papajtueshmërinë e personit tuaj. Janë 4 anëtarët e tjerë.

Z. I. Rusmali: Është e rëndësishme për KAS-in ta dijë.

Z. A. Kaziaj: Le të pyesin 4 anëtarët e tjerë, juve nuk ju kthej përgjigje.


Z. E. Çefa: Zoti Kaziaj, na specifikoni ju lutem dispozitën ku bazoheni për këtë kërkesë paraprake, përpara KAS-it.

Z. A. Kaziaj: Më lini kohën ta bëj me shkrim dhe t'ia sjell me shkrim KAS-it, ndërkohë që më vini në dispozicion një kopje të vendimit që sapo kërkova. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Me sa di unë as ne nuk kemi vendim. Pra, pjesën arsyetuese nuk e kemi as ne. Unë iu referova dispozitivit të shkurtuar ashtu sikundër e keni edhe ju. Kështu që nuk kemi asnjë gjë faktikisht. Nuk e dimë argumentin pse Kolegji Zgjedhor e ka konstatuar absolutisht të pavlefshëm vendimin tonë. Por që nuk mund të presim përtej ditës së sotme, sepse ai na ka urdhëruar që sot duhet të marrim vendim. Kështu që sot do ta ndajmë këtë punë.

Z. L. Braho: Zoti Kaziaj, i referoheni nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, që janë pengesat ligjore që nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë. Nga citoni 5 në cilat nga këto pika bazohet kërkesa juaj, një apo më shumë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. Sh. Sulo: Ju lutem, nuk do të bëjmë ne tani teknikë legislative.

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, ti mos fol fare!

Ju lutem, mbani qetësi!

(Diskutime pa mikrofon)

Z. E. Çefa: Atëherë, do të na sqarojë 2 sekonda ai dhe ne do të japim vendimin për kërkesën paraprake. Atëherë, mund të fillojmë, ndryshe nuk mund të vazhdojmë dot.

Z. A. Kaziaj: Zoti Braho, faleminderit për pyetjen! Ndërkohë që edhe relatori kërkoi se ku bazohet kërkesa jonë lidhur me përjashtimin dhe garantimin e paanshmërisë të anëtarit Rusmali. Në nenin 30 pengesat ligjore pika e parë shkronja “a”. Ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ka të bëjë me një kandidim që zoti Rusmali, siç e dini dhe ju është fakt i njohur botërisht, kandidon për një pozicion të lartë publik.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë, e ndërpresim 5 minuta dhe do të ritakohemi këtu për 5 minuta.

Rifillon mbledhja

Ora: 13:03

Z. E. Çefa: E riçelim edhe një herë seancën. Atëherë KAS –i, i konsultuar në vend, vendosi rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e anëtarit Ilirjan Rusmali nga ky

***Zbardhi materialin audio
Alma KOLA***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

procedim administrativ. Arsyet sigurisht do të shpjegohen në një pjesë të veçantë të vendimit. Viojmë aty ku e lamë. Ia jap fjalën përsëri zotit Kaziaj.

Z. A. Kaziaj: Më falni, zoti Çefa, por për solemnitet të vendimmarrjes suaj, mundet që ju të mblidheni në dhomë këshillimi. Kërkohet përjashtimi, po më falni, unë kërkoj përjashtimin e një anëtari, anëtari duhet të dalë jashtë kur të jetë vendimmarrja juaj.

Z. E. Çefa: Zoti Kaziaj, do t'jua shpjegoj unë.

Z. A. Kaziaj: Ju lutem, tani nuk mund të rrini në brendësi të një salle me 4 anëtarët e tjerë që do të vlerësojnë këto gjëra.

(Diskutime pa mikrofon)

Çfarë gjyqi po do t'i them atij personit që thatë ju të m'i shpjegojë. Ju i njihni i shkruani dhe i bëni vetë dhe merrni të njëjtin pozicion që i bëni rregullat vetë. Atë gjë nuk kam për ta bërë.

Z. I. Rusmali: Ju jeni shumë i dobët.

Z. A. Kaziaj: Shumë i dobët, por e di e keni mllefin e brendshëm. Rregullat i njihni ju nëpërmjet shërbimeve politike që po bëni për t'u katapultuar, e di shumë mirë.

Z. E. Çefa: Zoti Kaziaj, do t'ju sqaroj unë për këtë. Zoti Kaziaj, do t'jua jap fjalën.

Z. K. Bele: Vetëm, një sqarim ne nuk kemi asnjë pengesë që ta marrim vendimin të konsultuar në vend. Keni vajtur mjaftueshëm në gjykatë sa ta dini që mund të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

tërhiqesh ose ta marrësh vendimin. Se çfarë ndodh në këtë sallë dhe çfarë bëjmë ne, ju lutem, mos na komento. Të vazhdojmë seancën. Argumentet dhe të drejtën për të arsyetuar nuk jua ka penguar njeri. Ne jemi profesionistë të ligjit, kemi vite që merremi me këtë punë. Mund të mos e pëlqejmë njëri-tjetrin në këto pozicione të caktuara, por është e udhës, kemi mbase ditë dhe javë të tjera përpara procese, pra, është e udhës që të kthehemi në ato shina dhe ta mbajmë debatin në nivel teknik, ligjor, sigurisht ka konsiderata, të cilat nuk i ndajmë me njëri tjetrin. U parashtruan se çfarë ishte për t'u thënë, vazhdojmë me shqyrtimin e çështjes.

Z. A. Kaziaj: Zoti Bele, faleminderit që na udhëzoni të sillemi sipas asaj që ju doni. Ne nuk kemi dalë asnjëherë nga respekti kundrejt njëri- tjetrit dhe këtë ju nuk mund ta pretendoni, apo jo, të kundërtën të paktën. Ju ka munguar njeri respektin? A ju ka ndërhyrë njeri në vendimmarrje? Çfarë lidhje kanë çështjet teknike për një kërkesë të procedurës? Na morët si shembull gjykatat që mund të konsultohen në vend. Po patjetër, por anëtari, për të cilin kërkohet përjashtimi, nuk mund të rrijë në vend.

Z. E. Çefa: Zoti Kaziaj, tani do ta sqaroj. Ju ngritët disa pretendime konkrete.

Z. A. Kaziaj: Çfarë janë këto tani? Çfarë interesi keni ju që ndërhyri në këtë rast, kur kërkoj një kërkesë të karakterit të procedurës? Zotëri, kërkova përjashtimin? A u largua personi? A patët ju një vendimmarrje të pacenuar dhe të pa vesuar? Kaq dua të di.

Z. E. Çefa: Jua jap unë përgjigjen. Tani zoti Kaziaj ky do të jetë debati i fundit për këtë pjesë të vendimit. KAS-i, në shqyrtim të pretendimeve tuaja, e pa të udhës që duhet t'i kërkonim shpjegime zotit Rusmali për ato që ju pretenduat në këtë seancë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

5 minuta përpara. Dhe prezenca e tij ishte, në fakt, e domosdoshme për ne, që ne të merrnim një vendim, sepse i bëmë dy-tri pyetje dhe atij të karakterit gjysmë personal, ashtu sikundër edhe ju e ngritët ankesën. U sqaruam dhë pastaj u konsultuam me njëri-tjetrin. dakord?

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, me lejen tuaj do të kalojmë në fazën tjetër tani, sepse Kolegji brenda datës së sotme, orës 23.59, duhet të marrë vendim, kështu që unë them që të vazhdojmë të jemi në respekt të kohës.

Z. Sh. Sulo: Zbatoni Kodin.

Z. E. Çefa: Po ia jap fjalën zotit Kaziaj, këtë radhë për të parashtruar argumentet kundër vendimit numër 404, të Komisionerit. Faleminderit, zoti Kaziaj, fjala për ju.

Z. A. Kaziaj: Relator faleminderit për fjalën! Duke qenë se zoti Bele nuk ishte pjesë e seancës së shkuar në KAS, po mundohem të jem pak më i shkurtër në qëndrimet e mbajtura. Tashmë ju e keni të regjistruar atë që ka qenë shkresa jonë, apo kërkesa ankimore për vënien në lëvizje tuajën, lidhur me atë që është objekti i kundërshtimit të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 404. Lidhur me ditën e djeshme, Kolegji, pas vendimmarrjes suaj që mban numrin 71, datë 02.05.2023, Kolegji ju ka kthyer mbrapsht duke bërë edhe disa pyetje të karakterit logjik, sepse keni marrë një vendimmarrje 2 pro dhe 2 kundër, ndërkohë që keni rrëzuar kërkesë padinë. Dhe disa nga anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor kanë pretenduar, por në momentin që ligji nuk përcakton, neni 21, pika 3, e Kodit Zgjedhor, nuk përcakton, të themi, në këtë rast, një vendimmarrje me dy vota, dhe ju e keni marrë me dy vota vendimmarrjen, pse e keni rrëzuar ju kërkesë-padinë? Dhe pse nuk e keni pranuar

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

ju me dy vota kërkesë padinë? Këtë gjë unë dua ta dëgjoj nga ata që kanë qenë anëtarët rrezues, të themi, të kërkesës sonë ankimore? Sa i përket pjesës së thelbit ju tashmë e dini fare mirë se ne kundërshtojmë këtë vendim si vendim të pabazuar në ligj dhe në prova, për shkak të interpretimit të dyshimtë të bërë asaj që është dispozita kalimtare neni 183, pika 8, për shkak se, ashtu si edhe zoti Rusmali e tha, ka të bëjë me një qëndrim politik të unifikuar. Por qëndrimi politik i unifikuar në një marrëveshje të tillë politike ka të bëjë me një interes të ligjshëm të baraspeshimit të forcave politike dhe jo dhënien e avantazheve të një force dhe zbulimin e forcave të tjera politike të opozitës. Ky ka qenë parimi i dispozitës kalimtarë që ligjvënësi e ka futur në Kod Zgjedhor për ta përdorur në raste, siç po përdoret në këto zgjedhje. Sa i përket pjesës së argumentimit në kemi vënë në dispozicion edhe qëndrimet e mbajtura nga Kolegji Zgjedhor që ka të bëjë me vendimin nr. 10, datë 06.06. 2019 të Kolegjit Zgjedhor që flet për interesin e ligjshëm që flet për pjesëmarrjen në zgjedhje. Për analogji, pjesëmarrja në zgjedhje përbën element thelbësor për garantimin e privilegjeve të ligjit. Pjesëmarrja në zgjedhje do të thotë që në 61 bashki të kishte 61 kandidatë, në 61 bashki të ishin 61 lista për anëtarë të këshillit bashkiak. Në këtë rast pala e interesuar në këtë proces nuk e ka. Në këtë rast pala e interesuar në këtë proces është bërë palë me vetë politikën e kësaj qeverie, me politikën që më së miri Kryetarja e Kuvendit nëpërmjet shkresave të saj i ka kthyer përgjigje Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili i ka bërë disa pyetje lidhur me qëndrimet e mbajtura nga anëtarët ose nga të zgjedhurit e PDIU-së, të cilët që në momentin e parë të konstituimit të Kuvendit të vitit 2017 kanë pasur një qëndrim asnjës duke thënë se jemi deputetë të pavarur. Jo vetëm këtë, por Komisioneri i ka kërkuar Kryetares së Kuvendit edhe votimet e deputetëve, si kanë votuar, ligjvënësit shqiptar. Nuk kanë kthyer përgjigje, ose ka kthyer përgjigje nëpërmjet një linku, shiheni vetë si kanë votuar. Duket mosgatishmëria e Kryetares së Kuvendit duke u

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

bërë palë me arritjen e qëllimit të tyre të pasjes së më shumë personave dhe garantimit nga ana e tyre të numërimit të votave njëanshmërisht në këtë rast. Pavarësisht kësaj, Kryetarja e Kuvendit në mënyrë absurde i kthen përgjigje Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke thënë që nuk disponojnë, të themi veç asaj që është parashikimi në nenin 15 të Rregullores së Kuvendit, ne nuk disponojmë qëndrime të mbajtura nga anëtarët e Kuvendit sa i përket pjesës së përkatësisë së tyre politike. Kjo nuk është e vërtetë. Unë e ngrita dhe në Kolegj ditën e djeshme. Po të shihni atë që është marrëveshja politike e bërë nga të tria subjektet që përfaqësojnë koalicionin “Bashkë Fitojmë”, ju tashmë jeni njohur me të dhe në seancat e shkuara, një nga detyrimet e marrëveshjes është ajo që parashikohet në nenin 68 pika 3, pra të sjelljes së përkatësisë politike nëpërmjet vetëdeklarimeve të të zgjedhurve në këtë rast, të subjektit Partia e Lirisë. Ja ku e kemi, me vulë të Kuvendit, sekretaria e Kuvendit të Shqipërisë me protokoll dhe me të gjitha, Petrit Kozma Vasili dhe jo si e quajti zotëria: Vetëdeklarim; neni 68 pika 3, Kodi Zgjedhor, “përfaqësoj partinë politike Partia e Lirisë”, e dalë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe 3 deputetë të tjerë që përfaqësojnë Partinë e Lirisë. Ndërkohë Kryetarja e Kuvendit thotë se nuk kemi ne të dhëna lidhur me vetëdeklarimin se kujt i përkasin deputetët e parlamentit të Shqipërisë. Unë i bëj një pyetje kësaj trupe kuazi gjyqësore: Më falni, a ka sjellë sipas nenit 96, personi i interesuar ose pala e tretë në këtë proces 2 vetëdeklarime të kësaj natyre, që të futet në atë që është kërkesa e ligjit? Pra, dy ose më shumë deputetë thotë ligji. A i dispononi ju si trupë këto gjëra? Flitet gjithmonë për vitin 2017. Nëse do të merrni dispozitat kalimtare flitet për vitin 2017. Kështu që të 2017-ës, thotë ligji, të kenë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse të Kuvendit të Shqipërisë. Ndërkohë që 183/8-ta thotë që për zgjedhjet e para të Kuvendit, zgjedhjet e para të pjesshme vendore përcaktohet në konstituimin e zgjedhjeve të vitit 2017. Tani, a i disponon kjo trupë dy deklarime të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

PDIU-së, të deputetëve të saj të vitit 2017, ose të cilitdo vit, për të hyrë në atë që është parashikimi ose privilegji i ligjvënësit? Se deri ditën e djeshme në Kolegj nuk i dispononte. Pra, është një analogji shumë pastër kjo gjë, ndërkohë që shohim një keqdashje të shumë institucioneve shtetërore, përfshi këtu edhe Kryetaren e Kuvendit, e cila kthen një përgjigje të palogjikshme dhe të pambështetur në ligj, ndërkohë që kemi prova të mjaftueshme që ka shumë deputetë të tjerë, të cilët kanë vetëdeklaruar përkatësinë e tyre të partisë për të cilën janë zgjedhur dhe të partisë për të cilën mbrojnë interesat në Kuvendin e Shqipërisë. Ky është një fakt tashmë i njohur. Për sa u përket këtyre elementeve, unë do të doja t'i vija në vëmendjen tuaj në këtë rast, dhe t'i kërkoj palës lidhur me një dokumentacion që e vërteton këtë fakt. Për sa i përket pjesës së atyre që është baraspeshimi politik, e kemi thënë edhe në seancën e shkuar, kur është bërë përpara se të merrej vendimi nr. 71 nga ana juaj, që duhet garantuar baraspesha politike. E kanë arsyetuar më së miri në frymën e ligjit dhe në frymën e qëndrimit të mbajtur 2 anëtarët e Kolegjit, të cilët kanë qenë pro vendimmarrjes. Më së miri e ka vlerësuar këtë gjë duke jua kthyer dhe juve për rishikim ose për vendimmarrje edhe Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, në këndvështrimin tonë, duke pranuar pjesërisht kërkesë-padinë dhe duke ju sjellë në vëmendje juve një paligjshmëri të marrë, se na flet për ligj zoti Rusmali, por ndërkohë vendos rrëzimin e kërkesës me 2 vota. E drejta është e drejtë dhe ligji mund të lexohet në mënyrë të ndryshme për interesa të caktuara, po rrëzim kërkesë me 2 vota pro dhe 2 vota kundër, mbase jam shumë i ri, nuk e kisha parë ndonjëherë në eksperiencën time.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit do t'i themi atij zotërisë që thatë ju, patjetër, që të na mësojë pak më shumë! Përfundimisht kërkojmë nga ana juaj, të nderuar anëtarë, ndonëse tashmë qëndrimet e mbajtura edhe nga kolegu që mungonte kanë qenë të tilla për të orientuar një vendimmarrje tashmë të marrë, kemi kundërshtuar vendimin nr. 404 datë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

24.04.2023 dhe kërkojmë përfundimisht ndryshimin e këtij vendimi duke caktuar Partinë e Lirisë si parti që i lind e drejta për propozimin e anëtarit të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore datë 14 maj 2023. Faleminderit, dhe më falni, që ju lodha pak me parashtrimin!


Z. E. Çefa: Faleminderit, zoti Kaziaj! Po ia japim fjalën personit të interesuar, ndonëse proceduralisht i takonte sekretarit të Përgjithshëm, po s'ka problem.

Z. K. Xhemali: E respektoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, meqenëse në Kolegjin Zgjedhor ishte palë me ankuesin dhe me paditësin. Të lutem, faleminderit!

Z. E. Çefa: Jo, s'ka problem kështu vepruam edhe herën tjetër, vazhdoni.

Z. Sh. Sulo: Faleminderit, zoti relator! Të nderuar anëtarë të KAS-it, për sa i përket ankuesit në ankesën e bërë prej tij, tashmë u pa qartë që përveçse perifrazimeve politike, pyetjeve dhe debateve ku 2 anëtarët e KAS-it qenkan patronazhistë, 2 të tjerë qenkan më të mirë dhe tjetri mungonte, referuar edhe vendimit të Kolegjit Zgjedhor, në raport kur u pyet administrata e KQZ-së pse u mor vendimi 2 me 2, u pyet edhe vetë paditësi dhe nuk dha shpjegim, ndërsa unë, për përvojën e madhe, ndoshta e kisha gabim, i thashë që u mor 2 me 2 dhe quhet rrëzim, sepse nuk merrej për t'i hapur rrugë Kolegjit. Ky ishte mendimi im. Unë po flas në aspektin ligjor, më pas shumë pak do të flas në aspektin politik, meqenëse edhe kjo ankesë është tërësisht politike. Po a ka qenë kjo trupë zgjedhore që ka marrë një vendim në 2021-shin me një ankesë të bërë nga PDIU-ja? Pavarësisht se ne kemi qenë në koalicion me LSI-së dhe me PD-në, pavarësisht se dispozita transitore, e cila, siç u theksua dhe këtu, që unë kam qenë anëtar, ekspert i opozitës bashkë edhe me një kolegun

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

tuaj, i cili është në trupën e Rregullatorit, ka qenë ekspert përfaqësues i LSI-së, dhe është kërkuar me ngulm nga përfaqësuesi i partisë së zotërisë, deputet i nderuar për mua, dhe është kërkuar që kjo dispozitë të bëhej për zgjedhjet e para vendore dhe ato parlamentare. Pse pikërisht në 2021-shin kjo trupë e KAS-it nuk e ngriti këtë problem, që PDIU-ja nuk është forcë parlamentare? Nuk u diskutua sa deputetë kishte, kur fare qartë dokumentacioni i sjellë nga administrata zgjedhore i përmend se sa deputetë ka PDIU-ja në zgjedhjet e 2017-s. Por argumentimi i bërë nga ana juaj, nga Komisioneri dhe nga Kolegji ishte se nuk na takon për shkak të marrëveshjes, dhe ne si subjekt politik për mos të sjellë pësjtjellime në këtë gjë, nuk ankmuam, siç edhe sot nuk e keni ngritur zërin në asnjë nga trupat gjyqësore apo trupat e KQZ-së. LSI-ja dhe Partia e Lirisë, mund t'i futeshim edhe një analize tjetër që përse. Neni 183, pika 8 e saktëson fare qartë që a është apo jo parti parlamentare. Dokumentacioni i sjellë nga administrata e Kuvendit të Shqipërisë thotë që PDIU-ja është parti parlamentare. Në nenet 95 dhe 96 saktësohet fare qartë se kujt i takojnë anëtarët e grupit të numërimit, por edhe vetë nuk u citua, për çudi, sot asnjë vendim i Kolegjit Zgjedhor, që i referoheshin. Ne kemi vendimin e Kolegjit Zgjedhor të 2019-s, të 2021-shit dhe çfarë thonë? Në referim të vendimit të Kolegjit Zgjedhor, i cili përcakton si moment me cilin duhet vlerësuar përkatësia në partitë e shumicës apo opozitës parlamentare, nuk është pozicioni faktik që zënë këto parti në një moment të caktuar, por pozicioni që kanë këto parti kanë në zgjedhjet pararendëse në Kuvendin e Shqipërisë. E ka zgjedhur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me anë të vendimit, ka thënë: po kjo është parti parlamentare me kaq deputetë. Pozita e PDIU-së me pas njihet botërisht, në 2017-n po dhe në 2023-shin. Marrëveshja e bërë me ish-kryetarin Lulzim Basha "Çadra" ne nuk morëm pjesë në zgjedhjet e zhvilluara më pas, siç nuk morën pjesë as këta. Sot ne kemi 4 deputetë dhe këta kanë 4 deputetë, se njëri shkoi me pozitën. As Komisioneri dhe askush nga anëtarët e trupës

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

zgjedhore, askush nga anëtarët këtu, askush nga ata të Kolegjit apo askush nga ata të tjerët, që janë në Kuvendin e Shqipërisë, nuk kanë qenë pjesë e PDIU –së. Subjekt politik, i cili është qëlluar në çdo lloj momenti, nga çdo lloj force, ka qenë PDIU-ja. Nuk e themi ne, e thonë edhe raportet e OSBE-ODIHR-it, që e përcaktojnë fare qartë dhe përsëri ne si force politike, si subjekt zgjedhor i regjistruar në këto zgjedhje, nuk kemi mbajtur asnjë lloj qëndrimi dashakeqës, por jemi mbështetur vetëm te respekti karshi këtij institucioni. Flitet për anëtarë që i bëjnë temena PDIU-së. Kush janë, cilët janë? Por është fakt i njohur që Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet ka furnizuar partitë e tjera me deputetë të komunitetit çam. Lind pyetja: kush është numëruesi? Unë nuk po them se e kanë sqaruar se kush është numëruesi 2 të tjerët, 2 që janë me mua, po edhe ata 2 tjerët që ishin kundër meje. Numëruesi është një administrator, është një punonjës i KQZ-së, që propozohet nga një forcë politike dhe shkon dhe numëron votat e të gjithëve dhe mban edhe përgjegjësi. Më duhet të sjell edhe një fakt tjetër, përfaqësuesi ligjor, një jurist i nderuar i LSI-së, që ka qenë para kolegut tim, ka qenë avokat mbrojtës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Kavajë, ku komisionerët e LSI-së akuzoheshin për vjedhje votash. Po kanë 30 vjet LSI-ja dhe PS-ja dhe PD-ja që numërojnë votat. PD-në nuk dua ta zë në gojë, se është imja, po PS-ja, LSI-ja kanë 30 vjet që vjedhin votat, 30 vjet që janë nëpër kolegje, nëpër gjykata. Kjo është e vërteta. Ai është një punonjës i administratës shtetërore, që paguhet dhe mban përgjegjësi ligjore. Atëherë ku është e keqja këtu? Cili kush është baraspeshimi politik? Të lëmë vetëm PS-në dhe LSI-në të numërojnë votat?! Atëherë, për partitë e tjera, të cilat janë regjistruar në këtë proces zgjedhor, çfarë do të bëjnë, do të ngremë pyetjen: ore, kush do t'i numërojë? Po Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që mbas mbarimit të zgjedhjeve bën shumë seanca ku vërteton etj, etj gjëra, i bën vetëm për PDIU –në? Çfarë votash numërohen? E thamë çfarë votash numërohen, numërohen të gjitha votat, e të gjithë kandidatëve për këshillin bashkiak

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

dhe të gjithëve kryetarëve që janë kandidatë për bashkinë në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe mbajnë përgjegjësi përpara ligjit si ai numëruesi i LSI-së dhe numëruesi i PDIU-së apo i kujtdo force tjetër qoftë. Kjo është forca jonë politike, ky është respekti që unë vij dhe përfaqësoj një forcë politike me 4 deputetë, të cilët 90% janë studentë të dhjetorit me fakte, janë persona luajal dhe të pacenuar nga ligji, janë persona që nuk janë në SPAK dhe nuk janë persona që venë dhe shpalosin programin e tyre në gazetën “Kathimerini” në Greqi për tokat shqiptare. Jemi forcë politike subjekt që vijmë dhe kërkojmë zbatimin e ligjit për të sjellë kandidatë të shkëlqyer dhe jo kandidatë të cilët nuk ka ligj dhe burrë nënë që t’i heqin nga përgjegjësia e vrasjes së shqiptarëve dhe dhunimit të simboleve të Shqipërisë. Kjo është PDIU-ja. Prandaj më fal, zoti relator, kërkoj rrëzimin. Të lutem, unë nuk bëra analogji me asnjë nga kolegët këtu, sepse, e thashë edhe pak më parë, që unë ndjehem fare i qetë, sepse janë kolegë që unë punoj çdo ditë, bashkë me shokun Kaziaj, të LSI-së që punojmë çdo ditë gjykatë, dhe e dimë shumë mirë, por kërkoj, i nderuar zoti relator, e nderuar trupë gjyqësore, të paktën, një herë në 30 vjet jepini PDIU-së numërues, se nuk ju gjen gjë. Zbatoni ligjin, mos rrini nën presionin e LSI-së, që thotë ligji është ashtu, sepse kur u duhet ligji, ata e lexojnë siç ju intereson atyre. Kërkoj përfundimisht rrëzimin e ankesës së bërë nga subjekti LSI-së, pagëzuar me emrin Partia e Lirisë si e pambështetur...

Z. E. Çefa: Edhe një herë ju tërheq vëmendjen. Të lutem shumë, përshtypjet personale i leni mënjandë, këtu flasim me dokumentacion ligjor.

Z. Sh. Sulo: Lënien në fuqi të vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit, ku ky anëtar të ndahet midis

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

forcave të cilat i ka caktuar ligji siç ka caktuar edhe Komisioneri. Faleminderit dhe ndjesë!

Z. E. Çefa: Faleminderit!

Z. A. Kaziaj: A mundem një sekondë të vetme? Faleminderit, zoti Çefa! Deri te qëndrimi i fundit po shkonte mirë kolegu, aty e bëri si Kozma Dushi, që tha po “babuçit” do t’ia jepni një herë një vend të parë. Kështu që po ju kërkon që t’ia jepni për bono këtë qëndrim tijn. “Babuçit” të Beratit nuk i dhanë asnjëherë një vend të parë, por vend të dytë merrte i shkreti gjithmonë, po pavarësisht shakasë, do të ma lejosh, sjell në vëmendjen tuaj, besoj që KQZ-ja është në dijeni që ndërmjet periudhës kohore të vendimmarrjes suaj dhe vendimmarrjes, flas për 71-shin dhe vendimmarrjes së Kolegjit, jemi informuar nga ana e ZAZ-së 68, në qoftë se s’gabo, që është në Skrapar, lidhur me mosdërgimin e atyre që kanë qenë propozimet nga ana e PDIU-së për anëtarët e GNV-së. Pra, besoj në prezencë dhe të administratës së KQZ-së dhe të sekretarit të Përgjithshëm, nuk e di si ka vepruar KQZ-ja në këtë rast, ndërkohë që mund të ndodhin fakte dhe problematika të kësaj natyre, duke mos e garantuar vetë mosmarrjen e masave në vetvete për të pasur propozime dhe për të pasur persona në tavolinën e numërimit, ndërkohë që shohim që s’kanë pasur interes, si nuk kanë pasur interes në Skrapar, nuk kanë pasur në shumë nga bashkitë shqiptare për shkak se garojnë vetëm në një bashki. Duhet marrë parasysh edhe kjo gjë dhe kërkoj edhe nga sekretari i Përgjithshëm të japë një përgjigje se si është çmuar për t’u proceduar në këtë problematikë.

Z. E. Çefa: Po faleminderit! Po zoti Rusmaili.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. I. Rusmali: Zoti Kaziaj, me gjithë respektin, sapo na tha që “babuçit” nuk ia japin vendin e parë, se nuk i takon. Tani “babuçit”, e gjykojnë trupat që gjykojnë, nuk e gjykon pala, kështu që se çfarë ndodh te KZAZ –ja 68 është problem i administratës së KQZ-së, nuk është problem i KAS –it. KAS-i ka një lëndë shumë specifike për të shqyrtuar dhe ju kërkoj që të mos shpërndaheni në çështje të tjera, sepse ne në këtë vendimmarrje, kemi një lloj urgjence që na imponohet nga vendimi i Kolegjit Zgjedhor, nuk ka nevojë të shpërndahemi. “Babuçi” ka kohë akoma të marrë vendin e parë, mos na çoj andej.

Z. A. Kaziaj: Ishte pikërisht për këtë vendimmarrje, se ka të bëjë me propozimet për anëtar të GNV –së, pastaj për “babuçin” t’i japim kohën e vet.

Z. Sh. Sulo: Atëherë kërkoja në fillim që kjo trupë të vazhdojë të respektojë ligjin dhe mos të merret me gjëra të tjera. Meqenëse ma përmendi një KZAZ-në, është dhe një KZAZ tjetër në Tropojë, ku ne kemi bërë ankimet tona, por jo në këtë trupë zgjedhore. E kemi bërë të Komisioneri aty ku duhet. Para disa seancash ju kam thënë, emocionet që shoqërojnë kolegun tim, nga një pionier i Enverit, se kaloi 5 Maji, që bënte te Varrezat e Dëshmorëve në Berat, kërkon të më përfaqësojë mua si student i dhjetorit. Janë emocione që nuk i përballon dot, prandaj, të lutem, të vazhdojmë me vendimmarrjen.

Z. A. Kaziaj: Po tani, flasim për çështjen e procedurës. Ai thotë se kam bërë ankim për Tropojën të Komisioneri. A ke dërguar propozim, more zotëri, a ke dërguar propozime se, më duket se po ngatërron propozimet?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. Sh. Sulo: Do të ta kthej përgjigjen me shkrim.

Z. E. Çefa: Unë e kuptova shumë mirë argumentin tuaj, pse e sollët këtu, besoj edhe kolegët. Kështu që pa humbur kohë, ia jap fjalën sekretarit të Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaaj: Përfundimisht kërkojmë rrëzimin e kërkesës ankimore me nr. 53 datë 27.07.2023, të depozituar nga Partia e Lirisë dhe lënien fuqi të vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për caktimin e një partie politike të propozojë anëtarët e tretë dhe katërt të grupeve të numërimit për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit, zoti Merkaaj! Pra ju i qëndroni argumentit të bërë nga Komisioneri në këtë vendimmarrje. Përfundimisht, zoti Kaziqaj, konkluzionet përfundimtare?

Z. A. Kaziqaj: Përfundimisht, i nderuar zoti relator, ashtu siç e thashë në kërkesën tonë ankimore, i kërkojmë kësaj trupe ndryshimin e vendimit nr. 404 datë 24.04.2023 dhe caktimin e Partisë Lirisë si parti politike që e lind e drejta e propozimit të anëtarit të katërt të GNV –ve në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Përfaqësuesi i PDIU –së për konkluzionet.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

Z. K. Xhemali: Po, i nderuar zoti gjyqtar, përfundimisht kërkojmë mospranimin e këtij ankimi të pambështetur në prova dhe në ligj dhe lënien në fuqi të vendimit nr.404, datë 24.04.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Atëherë, KAS-i do të tërhiqet për vendim dhe do t'ju njoftojmë për pak minuta për ta shpallur. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 13:40

Z. E. Çefa: Riçelim edhe një herë seancën për shpalljen e vendimit lidhur me kërkesën ankimore nr. 53. Atëherë KAS-i, pasi e ridiskutoi çështjen edhe një herë në tërësi, me shumicë votash vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 53, datë 27.04.2023, depozituar nga subjekti zgjedhor Partia e Lirisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 404 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 90

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

**10.05.2023
Ora 15:10**

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve për kërkesat e Komisionerit nr. 24, 25, 26 dhe kërkesës ankimore nr. 56”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 10 maj 2023 ora 15:10, zhvillohet procedura për caktimin e relatorit të shortit, të kërkesës për vendosje sanksioni administrativ të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Cërrik dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Devoll, gjithashtu dhe kërkesa e Komisionerit numër 25, për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë Elbasan, ndaj kryetarit të Bashkisë Cërrik dhe ndaj kryetarit të Bashkisë Kamëz, kërkesa e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ me numër 26 për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj drejtorit të Qendrës Kulturore Margarita Tutulani Berat dhe kërkesa ankimore numër 56 me ankues Partia Socialiste me objekt ankimi kundërshtimi vendimit Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 407, datë 09.05.2023, procedura e shortit për caktimin e relatorit është parashikuar në nenin 14/35 të Rregullores së KAS-it, për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku në 4 janë vendosur kërkesat për vendosje sanksioni administrativ dhe kërkesa ankimore, të cilat fletët e letrës palosen dhe vendosen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qënë se anëtarët e KAS-it nuk

1

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.05.2023*

janë të pranishëm kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së t'i tërheqi në emër dhe për llogari të tyre goglat. Duke filluar me rendin alfabetik rritës, nga zoti Ervin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho. Pasi janë 5 gogla në një enë transparente përzihen nga përfaqësues i KQZ-së.

-Tërhiqet gogla -Vazhdojmë në emër dhe llogari të:

Z. Ervin Lako: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çefa: - kërkesa e Komisionerit numër 26.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - kërkesa e Komisionerit numër 24.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele: kërkesa ankimore numër 56.

Në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho: - kërkesa e Komisionerit numër 25.

Në përfundim të procedurës së shortit relator i kërkesës së Komisionerit numër 26 është zoti Elvis Çefa, relator i kërkesës numër 24 të Komisionerit është zoti Ilirjan Rusmali, relatori i kërkesës ankimore numër 56 është zoti Koli Bele dhe relator i kërkesës së Komisionerit për vendosje sanksioni administrativ numër 25 është zoti Ledio Braho faleminderit!

